

VENDIM
Nr. 404, datë 13.5.2015

PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN 2015 - 2020

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Integrimit Evropian, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2015 - 2020 (në vijim PKIE 2015 - 2020), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ministria e Integrimit Evropian orienton, bashkërendon dhe monitoron zbatimin e PKIE-së 2015 - 2020 nga grupet ndërinstitucionale të punës për çdo kapitull, të ngritura me urdhrin nr.107, datë 28.2.2014, të Kryeministrit, "Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian".
 3. Ministria e Integrimit Evropian raporton çdo 3 (tre) muaj në Këshillin e Ministrave për ecurinë e zbatimit të PKIE-së 2015 - 2020.
 4. Ministrinë dhe institucionet e tjera koor-dinuese të grupeve ndërinstitucionale të punës raportojnë pranë Ministrisë së Integrimit Evropian, çdo 3 muaj (java e tretë e muajit të fundit), për realizimin e detyrimeve, që rrjedhin nga PKIE-ja 2015 - 2020.
 5. Ngarkohet Ministria e Financave, që, në bashkëpunim me Ministrinë e Integrimit Evropian, të monitorojë përfshirjen, nga ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore në programin buxhetor afatmesëm, të nevojave financiare për zbatimin e përparësive afatshkurtra dhe afatmesme, të parashikuara në PKIE 2015 - 2020.
 6. Përkthimi në gjuhën angleze i PKIE-së 2015 - 2020 i bashkëlidhet këtij vendimi.
 7. Vendimi nr.438, datë 2.7.2014, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2014 - 2020", shfuqizohet.
 8. Ngarkohen të gjitha ministrinë dhe institucionet qendrore, për të cilat në PKIE 2015 - 2020 janë përcaktuar detyra të veçanta, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama